



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë/Ministarstvo Zdravstva/Ministry of Health

Nr. Xx/2020

Bazuar në nenin 132 të Ligjit Nr. 05/L -031 - Për procedurën e përgjithshme administrative, nenin 38 të Ligjit 04/L-190- Për Produkte dhe Pajisje medicinale, nenin 17 të Udhëzimit Administrativ 02/2019 - Për rregullimin e çmimeve të produkteve dhe pajisjeve medicinale, Vendimin nr. protokoll 35/2019, datë 27.06.2019, me rastin e shqyrtimit të kërkesës me Nr. 4/2, të datës 27.03.2020, nga Kompania AMICUS LLC, me seli në Prishtinë, me adresë: _____, me person përgjegjës Shqipe Gashi, të ushtruar kundrejt vendimit të komisionit për çmime të publikuar më 23 Mars në webfaqen e MSH, Komisioni për çmime, në takimin e mbajtur me datë 30.04.2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

Aprovohet pjesërisht kërkesa për rishqyrtim të çmimeve e parashtruar nga Kompania AMICUS LLC me seli në Prishtinë , rruga _____.

Çmimet finale janë si vijon:

- | | |
|---|---------|
| 1. Visipaque 320mg/ml, Glass vial: 10x100ml Solution for injection për të cilin ka aplikuar për çmimin | €288.53 |
| 2. Clariscan 0.5 mmol/ml, Glass vial: 10x10ml, Solution for injection për të cilin ka aplikuar për çmimin | €153.07 |
| 3. Clariscan 0.5 mmol/ml, Glass vial: 10x15ml, Solution for injection për të cilin ka aplikuar për çmimin | €236.73 |
| 4. Clariscan 0.5 mmol/ml, Glass vial: 10x20ml, Solution for injection për të cilin ka aplikuar për çmimin | €323.30 |

Arsyetimi

Ministria e Shëndetësisë, përkatësisht komisioni për çmime bazuar në dispozitat e Udhëzimit Administrativ 02/2019 për rregullimin e çmimeve të produkteve medicinale pas zhvillimit të procedurave të parapara me aplikacionet, dhe evalumin e tyre më datë 23 Mars 2020 ka publikuar vendimin për përcaktimin e çmimeve të produkteve medicinale të cilat posedojnë autorizim për marketing pranë AKPPM. Bazur në paragrafin 1 të nenit 17 kundër vendimit të komisionit pala ka të drejtë të parashtrorë kërkesë për rishqyrtim në komisionin për çmime në afat prej 8 ditësh nga dita e publikimit të vendimeve.

Kompania AMICUS LLC me seli në Prishtinë, rruga _____, bazuar në paragrafin 1 të nenit 17 të UA 02/2019, brenda afatit ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim të çmimeve të produkteve medicinale si vijon

1. Visipaque 320mg/ml, Glass vial: 10x100ml Solution for injection për të cilin ka aplikuar për çmimin €399.00
2. Clariscan 0.5 mmol/ml, Glass vial: 10x10ml, Solution for injection për të cilin ka aplikuar për çmimin €270.00
3. Clariscan 0.5 mmol/ml, Glass vial: 10x15ml, Solution for injection për të cilin ka aplikuar për çmimin €405.00
4. Clariscan 0.5 mmol/ml, Glass vial: 10x20ml, Solution for injection për të cilin ka aplikuar për çmimin €540.00

Komisioni duke u bazuar në dispozitat e udhëzimit administrativ përkatësisht në paragrafin 2 të nenit 17 të UA 02/2019 ka përcaktuar si vijon:


Emri i produktit	Prodhuesi	Forma farmaceutike	Fortesia	Madhesia e paketimit	Cmimi i deklaruar	Cmimi në € në vendet referente/origji nës	Çmimi final në Euro	Komenti nga komisioni
Visipaque	GE Healthcare	Solution for injection	320mg/ml	Glass vial: 10x100ml	399.00€	Mk – 288.53€ Hr – 382.84€	288.53€	Cmimi final është përzgjedhur në bazë të çmimeve të vendeve referente duke hequr çmimin e Kroacisë si çmim i lartë.
Clariscan	GE Healthcare	Solution for injection	0.5 mmol/ml	Glass vial: 10x10ml	270,00€	Hr- 153.10€ CZk – 208.60€	153.10€	Cmimi final është përzgjedhur në bazë të çmimeve të vendeve referente
Clariscan	GE Healthcare	Solution for injection	0.5 mmol/ml	Glass vial: 10x15ml	405,00€	Hr-236.73€ CZk-275.70€	236.73€	Cmimi final është përzgjedhur në bazë të çmimeve të vendeve referente
Clariscan	GE Healthcare	Solution for injection	0.5 mmol/ml	Glass vial: 10x20ml	540,00€	Hr-295.71€ Mk-350.82€	323.30€	Cmimi final është përzgjedhur në bazë të çmimeve të vendeve referente


Nga sa u tha u vendos si në dispozit të këtij vendimi.


Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala ka të drejtë të parashtrorë ankesë në afat prej 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit të vendimit, në Komisionin e ankesave në Ministrinë e Shëndetësisë.


Komisioni për çmime:


1. Naim Bardiqi MSH kryetar
2. Selvete Shuleta AKPPM anëtare
3. Etrit Tetova AKK anëtar
4. Amir Keka FSSH anëtar
5. Shkumbin Jusufi OFK anëtar
6. Dardan Nallbani anëtar MF **EPTINIS**
7. Blerta Kika MF anëtare
8. Haki Smajli MSh anëtar

















Vendimi i dërgohet:

Palës,

Departamenti farmaceutik,

Arkivës.